

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE TË VEÇANTA PËR
KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim Brandimi”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 79341400-0;79342200-5; 79800000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,997,887 (dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë) **Lekë, (pa TVSH)**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ”IdentiTek” SH.A, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1 Ofertuesi duhet të paraqesë::

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 9001:2015 (ose të përditësuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 45001:2018 (ose të përditësuar) e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 14001:2015 (ose të përditësuar) e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

Argumentim: *Certifikimet ISO janë certifikata që iu akordohen kompanive të cilat manifestojnë menaxhim të lartë bazuar në standartet ndërkombëtare të vendosura në përputhje me legjisacionin ndërkombëtar që e rregullon këtë fushë. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me*

kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.
 - b. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori/et ekonomik pjesëmarrës me qëllim realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, duhet të ketë të punësuar, minimalisht 6(gjashtë) persona të cilët do të kryejnë shërbimin brandimit, në profilet si mëposhtë:

➤ **2 (dy) punonjës me profil Grafik Dizajn,**

Për të cilët duhet të paraqes dokumentacionin si mëposhtë :

- Kontratë pune individuale;
- Diplomë përkatëse (nëse disponojnë);
- Çertifikatë kualifikimi, në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional dhe/ose çdo dokument që verteton kualifikimin përkatës, të lëshuar nga një Inspektorati shtetëror apo subjekt privat i akredituar.

➤ **4 (katër) punonjës teknik montimi,** për të cilët duhet të paraqes kontratën individuale të punës.

Shënim 2.1: Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit ofertuesi fitues duhet të dorëzojë pranë AK dokumentacionin e mësipërm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Për realizimin me cilësi të lartë grafike të kësaj procedure brandimi, është e domosdoshme që kompania fituese të ketë të paktën **2 grafik dizajnerë**, për të përballuar dizejnimin e një game të gjerë materialesh të llojeve të ndryshme dhe me vizuale të larmishme brenda afateve të kërkuara, si dhe për të garantuar përputhjen me identitetin institucional. Gjithashtu, kërkohen **4 teknikë montimi**, për të mundësuar instalimin paralel të sinjalistikës dhe strukturave fizike në disa lokacione ku kemi zyrat e aplikimit, në mënyrë të sigurt dhe sipas specifikimeve grafike. Kërkesa për këtë staf është kriter minimal për të përmbushur objektin e të kontratës brenda standardeve të kërkuara.

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë minimumi **3 makineri** me qëllim realizimin e shërbimit objekt prokurimi, të cilët duhet t’i ketë në pronësi ose me qira, të kategorizuara si mëposhtë:

- 1 (nje) makineri printimi
- 1(një) makineri printimi në 3D,
- 1 (një) makineri laser për prerje të ngurta, të llojit alumin, akrilik, etj

Shënim 3.1: Operatorët ekonomikë për pajisjet e kërkuara duhet të paraqesin pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacion që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për realizimin teknik të shërbimeve të parashikuara në këtë prokurim, operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 3 makineri specifike, që mbulojnë gamën e gjerë të materialeve dhe strukturave të kërkuara. Këto përfshijnë: 1 makineri printimi për prodhimin e

materialeve promocionale, 1 makineri 3D për elementë të veçantë dekorativë dhe strukturorë, si dhe 1 makineri laser për prerje të ngurta (akrilik, alumin, etj.) për sinjalistikën dhe strukturat fizike të brandimit. Prania e këtyre pajisjeve është thelbësore për të garantuar zbatim të saktë, cilësor dhe të pavarur brenda afateve të kontratës.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se me qëllim realizimin e shërbimit objekt prokurimi do të përdor bojra ekologjike dhe rezistente ndaj faktorëve atmosferik.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standarteve dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të shërbimeve dhe mallrave objekt prokurimi. Duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e materialeve të prokurimit (banera, sinjalistikë murale, adegjivë në xham, toteme informuese, tabela plexiglass etj.) do të ekspozohen në ambiente të jashtme apo gjysmë të hapura, dhe për rrjedhojë cilësia e bojës ndikon drejtpërdrejt në jetëgjatësinë, lexueshmërinë dhe imazhin e institucionit. Bojërat ekologjike përputhen gjithashtu me angazhimet e institucionit për të promovuar praktika të qëndrueshme dhe të sigurta për shëndetin e njerëzve dhe mjedisit.

5. Operatori ekonomik duhet të deklarojë garancinë e shërbimeve e cila duhet të jetë jo më pak se 1(një) vit, si dhe gjatë periudhës së garancisë ofertuesi duhet të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 1, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se shërbimi dhe produktet që do të ofrohen do të kenë një periudhë garancie të pakten 1 vjeçare dhe do të sigurojnë atyre mirëmbajtjen dhe riparimin pa pagesë gjatë periudhës së garancisë. Operatori duhet të ofrojë garanci 1-vjeçare me mirëmbajtje dhe riparim pa pagesë, sepse është thelbësore për të mbrojtur cilësinë, koherencën vizuale dhe funksionalitetin e elementëve të brandimit, veçanërisht për ato që vendosen në ambiente të jashtme dhe janë të ekspozuara ndaj konsumit ose faktorëve atmosferikë. Brandimi institucional nuk është vetëm produkt estetik, por një instrument komunikimi afatgjatë, dhe çdo deformim apo dështim teknik cënon imazhin dhe besueshmërinë e institucionit.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 11.09.2025 Ora:12:00